



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

BALANCA VJETORE (E REALIZUAR) E ENERGIJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2011

GODIŠNJI (REALIZOVANI) ENERGETSKI BALANS
REPUBLIKE KOSOVA ZA 2011. GODINU

ANNUAL (REALIZED) ENERGY BALANCE OF
REPUBLIC OF KOSOVO FOR THE YEAR 2011

Prishtinë, 2012



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

**BALANCA VJETORE (E REALIZUAR) E ENERGISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2011**

Prishtinë, 2012

Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Balancave të Energjisë në MZHE, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me entitetet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.07/20111 Mbi Rregullat për Balancën e Energjisë.

Përmbajtja

Shkurtesat

Përmbledhje ekzekutive

1. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2011	1
1.1. Burimet primare	1
1.1.1. Thëngjilli	2
1.1.2. Produktet e naftës	2
1.1.3. Biomasa (Dru zjarri)	3
1.1.4. Energjia Elektrike	4
1.1.5. Hidroenergja	4
1.1.6. Energjia e Erës	4
1.1.7. Energjia Solare	4
1.1.8. Biokarburantet	4
1.2. Konsumi i energjisë	4
1.2.1. Konsumi i thëngjillit	7
1.2.2. Konsumi i produkteve të naftës	8
1.2.3. Konsumi i energjisë elektrike	8
1.2.4. Konsumi i ngrohjes së përfituar	9
1.3. Konsumi në sektorin e industrisë	10
1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë	10
1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë	10
1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë	11
1.3.4. Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë	12
1.3.5. Pjesëmarrja e nënsektorëve të industrisë në konsumin energjisë.	13
1.4. Konsumi në sektorin e amvisërisë	14
1.4.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë	14
1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë	16
1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë	16
1.5. Konsumi në sektorin e shërbimeve	17
1.5.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve	17
1.5.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e shërbimeve	18
1.5.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve	19

1.6. Konsumi në sektorin e transportit	19
1.6.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit	19
1.7. Konsumi në sektorin e bujqësisë	20
1.7.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë	20
1.7.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë	21
1.7.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë	21
1.8. Mbulimi i kërkesës me energji	22
1.8.1. Furnizimi me thëngjill (lignit)	22
1.8.2. Furnizimi me energji elektrike	22
1.8.3. Furnizimi me produkte të naftës	23
1.9. Treguesit e konsumit të energjisë	24
1.10. Ndotja e mjedisit	24
2. Konkluzionet	25
SHTOJCAT	26
Shtojca 1. Karakteristikat e sistemit energjetik të Kosovës	27
Shtojca 2. Karakteristikat e burimeve energjetike dhe konvertimi i njësive	29
Shtojca 3. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2011	31

Shkurtesat

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh. a	Operatori i Sistemit dhe Tregut
KEK sh. a	Korporata Energjetike e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MF	Ministria e Financave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
DK	Doganat e Kosovës
SKE	Sekretariati i Komitetit të Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
CRES	Qendra për burime të ripërtritshme dhe kursim të energjisë, Athinë-Greqi
AIE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hydrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor
CO	Monoksid i karbonit
VOC	Përbërje organike lehtë e avullueshme
NO _x	Oksidet e azotit- NO dhe NO ₂
CO ₂	Dioksid i karbonit
SO ₂	Dioksid i sulfurit

Përmbledhje ekzekutive

Balanca vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2011 është përgatitur nga divizioni përgjegjës për balanca të energjisë në kuadër të departamentit përgjegjës për energji dhe miniera në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2011 është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 Mbi Rregullat për Balancat e Energjisë.

Në këtë dokument pasqyrohen rrjedhat e energjisë të të gjitha llojeve dhe burimeve që janë përdorur në Kosovë gjatë vitit 2011.

Të dhënat janë grumbulluar nga entitetet si në vijim:

- Ministria e Financave – të dhënat për BPV;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës - të dhënat demografike dhe sociale;
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh. a) – të dhënat për thëngjillin (prodhimi, furnizimi dhe stoqet) si dhe të dhënat për konsumin e energjisë elektrike;
- Operator i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu sh. a (KOSTT) - të dhëna periodike mujore, si dhe vjetore të balancës elektroenergjetike;
- “Kosova Thëngjilli” sh. a - të dhënat për tregtimin e thëngjillit të njomë dhe të terur, të nxjerrë nga mihjet në Kosovë;
- Doganat e Kosovës - të dhënat për importin dhe eksportin e të gjitha produkteve të energjisë;
- Ndërmarrjet e ngrohjeve qendrore - të dhënat për rrjedhat energjetike në ndërmarrjet e ngrohjes;
- MBPZHR dhe APK- të dhënat për drurin;
- MTI- të dhënat për përpunimin, importin dhe eksportin e produkteve të naftës.

Në këtë dokument analiza e konsumit të energjisë është bazuar në anketat dhe studimet e zhvilluara me qëllim të përgatitjeve për hartimin e dokumenteve të balancave të energjisë

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar, sistemuar dhe paraqitur sipas formatit të EUROSTAT-it.

1. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2011

Pjesët kryesore të Balancës së realizuar të energjisë janë: burimet primare - respektivisht furnizimi me energji dhe konsumi i energjisë apo shpërndarja e konsumit të energjisë sipas sektorëve ekonomikë. Të dy këto pjesë do të analizohen në vijim.

1.1. Burimet primare

Struktura e energjisë primare të konsumuar në Kosovë në vitin 2011 nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin 2010. Atë e përbëjnë: thëngjilli, produktet e naftës (benzina, dizelli, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës - GLN), biomasa, energjia elektrike, hidroenergji, energjia e erës, energjia solare dhe biokarburantet. Energjia elektrike si energji primare trajtohet energjia elektrike e importuar dhe e eksportuar.

Siç vërehet në tab.1, sasia bruto e energjisë në dispozicion në vitin 2011 ka qenë 2505.03 ktoe.

Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion

Burimet e energjisë	ktoe
Thëngjill	1623.49
Produkte naftë	591.56
Biomasë	241.93
Energjia elektrike	38.27
Hidroenergji	9.00
Energji solare	0.63
Energjia e erës	0.02
Biokarburante	0.13
Totali	2505.03

Të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga druri i zjarrit (biomasës) për vitin 2011 janë të bazuara në rezultatet e studimit të biomasës e kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë, të ekstrapoluar në baze të rritjes së numrit të amvisërive dhe GDP-së për vitin 2011 .




Figura 1. Pjesëmarrja e burimeve primare në dispozicion (%)

1.1.1. Thëngjilli

Sasia e thëngjillit në dispozicion për vitin 2011 ka qenë 1623.49 ktoe. Në tab.2, janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga thëngjilli.

Tabela 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion

Thëngjill	ktoe
Antracit	30.12
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00
Linjit	1593.43
Koks dhe gjysmë koks	-0.63
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.28
Katran	-0.06
Torfë	0.34
Totali i thëngjillit	1623.49




Figura 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Nga fig. 2, shihet që prej të gjitha llojeve të thëngjillit, linjiti ka një pjesëmarrje prej 98.14% në totalin e thëngjillit si burim primar në dispozicion, i pasuar nga antraciti me 1.84 % dhe briketet e thëngjillit të murrmë 0.02 %. Ka pasur vetëm linjiti si prodhim kurse të tjerët janë importuar.

1.1.2. Produktet e naftës

Importi i produkteve të naftës për vitin 2011 ka qenë 591.61 ktoe. Për dallim nga vitet e kaluara në vitin 2011 kemi pasur import të gazoilut dhe kerozinës si lëndë të parë për përpunim në impiantet për desulfurizim, ku kemi pasur një përpunim të naftës prej 6.53 ktoe dhe të mazutit prej 4.06 ktoe. Në tab. 3 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga produktet e naftës.

Tabela 3. Pasqyra e sasisë së produkteve të naftës (ktoe)

Produktet e naftës	ktoe
Benzinë	78.65
Gazoil	6.90
Kerozinë	1.63
Kerozinë (Jet fuel)	11.93
Vajra të rëndë/mazuti	74.57
Naftë	283.78
GLN	40.97
Koks nafte	43.07
Produkte tjera nafte	0.00
Mbetje nafte	0.00
Bitumen	50.07
Totali	591.56




Figura 3. Pjesëmarrja e produkteve të naftës si burime primare në dispozicion (%)

Nga fig.3, shihet që pjesëmarrja e naftës ka qenë më e larta nga të gjitha llojet tjera të produkteve të naftës me një pjesëmarrje prej 47.97% në totalin e sasisë së produkteve të naftës në dispozicion, e pasuar nga benzina me 13.29%, mazuti 12.60%, bitumen 8.46%, koks nafte 7.28% dhe GLN me 6.93%, etj.

1.1.3. Biomasa (Dru zjarri)

Vazhdon të mbetet problematike çështja e sigurimit të të dhënave për sasinë e druve të zjarrit të prera në Republikën e Kosovës. Të dhënat që ka në dispozicion Agjencia Pyjore e Kosovës flasin për një sasi shumë të vogël të druve të prera në Kosovë. Në anën tjetër, nevojat e vlerësuara të popullatës për ngrohje janë shumë herë më të larta sesa të dhënat zyrtare me të cilat disponohet.

Sasia e konsumuar e druve të zjarrit vetëm nga sektori i amvisërisë në vitin 2011 ka qenë 222.36 ktoe. Nëse i marrim parasysh të gjithë sektorët e ekonomisë, konsumi i drurit për zjarr gjatë vitit 2011 ka qenë 241.93 ktoe.

Të dhënat për konsumin e drurit janë marre nga studimi për konsumin e biomasesë "Studimi për konsumin e biomasesë për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë" i realizuar nga CRES-i dhe i kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë.

1.1.4. Energjia Elektrike

Bazuar në metodologjinë EUROSTAT të balancës së energjisë, energjia elektrike e importuar dhe ajo e eksportuar trajtohen si energji primare. Kjo energji, në vitin 2011 ka qenë 38.27 ktoe (import-eksport).

1.1.5. Hidroenergja

Të dhënat për hidroenergji janë siguruar nga KEK-u dhe KOSTT-i, të bazuara në sasinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet: HC Ujmani, HC Lumbardhi, HC Radavci, HC Dikanci. dhe HC Burimi.

Sasia e hidroenergjisë e prodhuar në hidrocentrale në vitin 2011 ka qenë 9.00 ktoe .

1.1.6. Energjia e Erës

Prodhimi i energjisë elektrike nga era për vitin 2011 ka qenë 281 MWh ose 0.02 ktoe.

1.1.7. Energjia Solare

Të dhënat për energjinë solare janë të vlerësuara në bazë të të dhënave të vitit 2008.

1.1.8. Biokarburantet

Biokarburantet bëjnë pjesë në burimet e ripërtitshme të energjisë. Kjo lëndë djegëse sigurohet nga importi, i cili për vitin 2011 ka qenë 0.13 ktoe.

1.2. Konsumi i energjisë

Konsumi i energjisë për vitin 2011¹ është bazuar në hulumtimin me anketa në të gjithë sektorët ekonomikë të realizuar në vitin 2009, 2010 dhe 2011. Të dhënat e konsumit për biomasën janë marrë nga rezultatet e anketës për konsumin e biomasës në sektorët e amvisërisë, shërbimeve dhe industrisë, projekt i kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë në vitin 2011, ndërsa konsumi për vitin 2011 është ekstrapoluar për rritjen e numrit të amvisërive (2% rritje vjetore) dhe rritjen e GDP-së (5.3%).

Shpërndarje e sasisë së energjisë nëpër sektorë është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Pasqyra e pjesëmarrjes së gjithë sektorëve në konsumin final energjetik

Sektorët ekonomikë	ktoe
Sektori i industrisë	315.64
Sektori i amvisërisë	490.51
Sektori i shërbimeve	119.57
Sektori i bujqësisë	19.95
Sektori i transportit	338.58
Totali	1284.25

Nga tab. 4, shihet se konsumi final energjetik për vitin 2011 ka qenë 1284.25 ktoe. Sektori me konsumin më të madh të energjisë për vitin 2011 është amvisëria me një konsum prej

¹“Konsumi i energjisë në Kosovë”, realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2009,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e industrisë dhe mundësia e përmirësimit të efijencës”, realizuar nga MPR GROUP në vitin 2010,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë dhe mundësia e përmirësimit të efijencës”-realizuar nga Instituti “Intech” në vitin 2011,

“Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë”, realizuar nga CRES në vitin 2011.

490.51 ktoe ose 38.2% të konsumit total, pasuar nga sektori i transportit me një konsum prej 338.58 ktoe ose 26.4%, sektori i industrisë me një konsum prej 315.64 ktoe ose 24.6%, sektori i shërbimeve me një konsum 119.57 ktoe ose 9.3% dhe sektori i bujqësisë me një konsum 19.95 ktoe ose 1.6%.




Figura 4. Pjesëmarrja e sektorëve të ekonomisë në konsumin e energjisë (%)

Konsumi final jo energjetik për vitin 2011 ka qenë 50.41 ktoe. Torfa është lloj i vetëm i thëngjillit i cili është konsumuar për qëllime jo energjetike në sektorin e industrisë kimike në sasi prej 0.34 ktoe. Ndërsa nën-produkti i naftës, bitumeni është i vetmi që është konsumuar për qëllime jo energjetike në vitin 2011 në sasi prej 50.07 ktoe. Në vazhdim paraqitet konsumi final jo energjetik dhe konsumi final i energjisë.

Tabela 5. Konsumi final jo energjetik

Sektorët ekonomikë	ktoe
Industria kimike	0.34
Sektorët tjerë	50.07
Totali	50.41

Tabela 6. Pasqyra e konsumit final të të gjitha burimeve të energjisë

Burimi	ktoe
Thëngjill	86.65
Produkte naftë	605.14
Biomasë	241.93
Biokarburante	0.13
Energji elektrike	396.80
Energji solare	0.63
Ngrohje e përfituar	3.04
Totali	1334.32




Figura 5. Pjesëmarrja në konsum e të gjitha burimeve të energjisë (%)

Nëse analizohet konsumi i të gjitha burimeve të energjisë (tabela 6) shihet që konsumi i derivateve të naftës për vitin 2011 ka qenë 605.14 ktoe ose 45.35% i konsumit total të të gjitha burimeve të energjisë, pasuar nga energjia elektrike me 396.80 ktoe ose 29.74% , biomasa me 241.93 ktoe ose 18.13%, thëngjilli me 86.65 ktoe ose 6.49%, ngrohja e përftuar me 3.04 ktoe, ose 0.23%, energjia solare me 0.63 ktoe ose 0.05% dhe biokarburantet me 0.13 ktoe ose 0.01% të konsumit total të të gjitha burimeve të energjisë.

Tabela 7. Energjia në dispozicion dhe konsumi (ktoe)

	Thëngjill	Produkte nafte	Biomasa	Energji elektrike	Bio-karburante	Energji solare	Ngrrohje e përfituar
Energjia në dispozicion	86.31	577.18	241.93	396.80	0.13	0.63	3.04
Konsumi final i energjisë	86.65	555.07	241.93	396.80	0.13	0.63	3.04
Konsumi final jo energjetik	0.34	50.07	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca	-0.68	-27.96	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00




Figura 6. Energjia në dispozicion dhe konsumi (ktoe)

1.2.1. Konsumi i thëngjillit

Konsumi final i nënprodukteve të thëngjillit paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 8. Pasqyra e konsumit final të thëngjillit

Thëngjill	ktoe
Antracit	30.12
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00
Linjit	56.25
Koks dhe gjysmë koks	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.28
Katran	0.00
Torfë	0.34
Totali	86.99




Figura 7. Pasqyra e konsumit të thëngjillit (%)

Nga tab.8, shihet se linjiti në vitin 2011 ishte thëngjilli më i konsumuar me një pjesëmarrje prej 56.25 ktoe ose 64.66% të konsumit total, pasuar nga antraciti me 30.12 ktoe ose 34.63%, torfa me 0.34 ktoe ose 0.40% por kjo sasi e torfës konsumohet për qëllime jo energjetike (shih tab. 7) dhe brikete të thëngjillit të murrmë me 0.28 ktoe ose 0.32%.

1.2.2. Konsumi i produkteve të naftës

Në vijim paraqitet konsumi final i të gjitha produkteve të naftës:

Tabela 9. Pasqyra e konsumit final të produkteve të naftës

Produkte nafte	ktoe
Benzinë	78.65
Gazoil	0.00
Kerozinë	0.00
Kerozinë (Jet fuel)	11.93
Vajra te rënda/mazuti	66.20
Naftë	303.96
GLN	51.27
Koks nafte	43.07
Produkte tjera nafte	0.00
Mbetje nafte	0
Bitumen	50.07
Totali	605.14




Figura 8. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës (%)

Siç shihet nga tab.9, nafta është nënprodukti më i konsumuar në vitin 2011 me një pjesëmarrje prej 303.96 ktoe ose 50.23% e konsumit total të derivateve të naftës, pasuar nga benzina me 78.65 ktoe ose 13.00%, mazuti me 66.20 ktoe ose 10.94%, GLN me 51.27 ktoe ose 8.47%, bitumeni me 50.07 ktoe ose 8.27%, por kjo sasi e bitumenit konsumohet për qëllime jo energjetike (shih tab. 7), koks nafte me 43.07 ktoe ose 7.12% dhe kerozinë (Jet fuel) 11.93 ktoe ose 1.97% të konsumit total të derivateve të naftës.

1.2.3 Konsumi i energjisë elektrike

Në vitin 2011 konsumi i energjisë elektrike ka qenë 396.80 ktoe. Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i energjisë elektrike në të gjithë sektorët ekonomikë.

Tabela 10. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike

Sektori	ktoe
Industria	111.36
Transporti	0.00
Amvisëria	216.85
Bujqësia	6.87
Shërbimet	61.72
Totali	396.80




Figura 9. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomikë (%)

Siç shihet nga tab. 10, sektori i amvisërisë është sektori me konsumin më të madh të energjisë elektrike prej 216.85 ktoe ose 54.65% të konsumit total të energjisë elektrike, e pasuar nga sektori i industrisë me konsum prej 111.36 ktoe ose 28.06%, sektori i shërbimeve me konsum prej 61.72 ktoe ose 15.55% dhe sektori i bujqësisë me konsum prej 6.87 ktoe ose 1.73%.

1.2.4. Konsumi i ngrohjes së përfiturar

Konsumi total i ngrohjes së përfiturar për vitin 2011 ka qenë 3.04 ktoe. Amvisëria është konsumatori kryesor me një konsum prej 1.98 ktoe ose 65% të konsumit total të ngrohjes së përfiturar, pasuar nga sektori i shërbimeve me konsum prej 1.06 ktoe ose 35%.

Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i ngrohjes së përfiturar në të gjithë sektorët ekonomikë.

Tabela 11. Pasqyra e konsumit të ngrohjes së përfiturar në të gjithë sektorët ekonomikë

Sektori	ktoe
Industria	0.00
Transporti	0.00
Amvisëria	1.98
Bujqësia	0.00
Shërbimet	1.06
Totali	3.04

1.3. Konsumi në sektorin e industrisë

1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë

Në vitin 2011 konsumi i energjisë në sektorin e industrisë ka qenë 315.64 ktoe. Si edhe në sektorët tjerë, të dhënat e konsumit të energjisë në përgjithësi janë bazuar në të dhënat e hulumtimit për konsumin e vitit 2008, 2009 dhe 2011², të dhënat nga faturimi i KEK-u, të dhënat nga Kosova Thëngjilli, të dhënat nga MTI-ja dhe analizës së rritjes ekonomike.

Tabela 12. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë

Burimi	ktoe
Thëngjill	59.14
Produkte nafte	134.12
Biomasë	11.01
Energji elektrike	111.36
Totali	315.64

Burimet energjetike më të konsumuara në sektorin e industrisë janë produktet e naftës me 134.12 ktoe ose 42.49% të konsumit total të sektorit të industrisë, pasuar nga energjia elektrike me 111.36 ktoe ose 35.28%, thëngjilli me 59.14 ktoe ose 18.74% dhe biomasa 11.01 ktoe ose 3.49%.




Figura 10. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (%)

1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë

Në tab. 13, shihet pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë. Pjesëmarrja e antracitit për vitin 2011 është me 30.12 ktoe ose me 50.93%, linjiti me 29.02 ktoe ose 49.07%.

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit lloj të thëngjillit në sektorin e industrisë.

² Konsumi i energjisë në Kosovë”, realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2009, Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e industrisë dhe mundësia e përmirësimit të efikasitetit”-realizuar nga MPR GROUP në vitin 2011, Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë”, realizuar nga CRES në vitin 2011.

Tabela 13. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë

Thëngjill	ktoe
Antracit	30.12
Thëngjill bituminozë dhe tjera	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00
Linjit	29.02
Koks dhe gjysmë koks	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00
Katran	0.00
Torfë	0.00
Totali	59.14




Figura 11. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë (%)

1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë

Në tab.14, shihet se në konsumin e derivateve të naftës në sektorin e industrisë në vitin 2011 prinë mazuti me 39.49%, pasuar nga koks naftë 32.11%, nafta me 18.45%, GLN me 9.50% dhe benzina me 0.45% të konsumit total të derivateve të naftës në sektorin e industrisë.

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit nënprodukt të naftës në sektorin e industrisë.

Tabela 14. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e industrisë

Produktet e naftës	ktoe
Benzinë	0.61
Gazoil	0.00
Kerozinë	0.00
Kerozinë (Jet fuel)	0.00
Vajra të rënda /mazut	52.96
Naftë	24.74
GLN	12.75
Koks nafte	43.07
Produkte tjera nafte	0.00
Mbetje nafte	0.00
Bitumen	0.00
Totali	134.12




Figura 12. Pjesëmarrja në konsum të produkteve të naftës në sektorin e industrisë (%)

Sektorin e industrisë përbëhet prej disa nënsektorëve të ndryshëm si: industria e hekurit dhe çelikut, metaleve joferrore, industria kimike, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore, industria e nxjerrjes së xeheve, industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit, industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes, industria e letrës dhe stampimit, inxhinieringut dhe industritë tjera të metaleve.

1.3.4 Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë

Konsumi total i energjisë elektrike në sektorin e industrisë për vitin 2011 ka qenë 111.36 ktoe. Industria e hekurit dhe çelikut është nënsektori i industrisë me konsumin më të lartë të energjisë elektrike me 45.33 ktoe ose 40.70% të konsumit total të energjisë elektrike në sektorin e industrisë, pasuar nga industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit me 41.66 ktoe ose 37.41%, industritë tjera me 15.73 ktoe ose 14.13%, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore me 5.45 ktoe ose 4.89% dhe industria e metelave e metaleve joferrore 1.44 ktoe ose 1.29%.

Tabela në vijim paraqet konsumin e energjisë elektrike në sektorin e industrisë.

Tabela 15. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë

Nën-sektorët e industrisë	ktoe
Industria e hekurit dhe çelikut	45.33
Industria e metaleve joferrore	1.44
Industria kimike	0.25
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	5.45
Industria e nxjerrjes së xeheve	1.24
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	41.66
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.09
Industria e letrës dhe stampimit	0.17
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01
Industritë tjera	15.73
Totali	111.36




Figura 13. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (%)

1.3.5 Pjesëmarrja e nënsektorëve të industrisë në konsumin e energjisë

Nëse analizohet konsumi i energjisë sipas nënsektorëve të industrisë për vitin 2011, prinë nënsektori i industrisë së ushqimit, pijeve dhe duhanit, i cili konsumon 83.80 ktoe ose 26.5% të totalit të energjisë së konsumuar nga sektori i industrisë, nënsektori i hekurit dhe çelikut me 69.03 ktoe ose 21.9% të konsumit total të energjisë, nënsektori i metaleve joferrore me 64.47 ktoe 20.4%, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore 60.69 ktoe ose 19.2%, përcjellë nga nënsektori industritë e tjera me 32.62 ktoe ose 10.3%.

Tabela në vijim paraqet konsumin në total të energjisë të nënsektorëve të industrisë:

Tabela 16. Pasqyra e konsumit total të energjisë të nënsektorëve të industrisë

Nën-sektorët e industrisë	ktoe
Industria e hekurit dhe çelikut	69.03
Industria e metaleve joferrere	64.47
Industria kimike	1.89
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	60.69
Industria e nxjerrjes së xeheve	2.70
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	83.80
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.17
Industria e letrës dhe stampimit	0.26
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01
Industritë tjera	32.62
Totali	315.64




Figura 14. Pasqyra e konsumit të energjisë të nënsektorëve të industrisë (%).

1.4. Konsumi në sektorin e amvisërisë

1.4.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë

Ashtu si në sektorët e tjerë, të dhënat e konsumit të energjisë në përgjithësi janë bazuar në të dhënat e hulumtimit për konsumin e vitit 2008, 2009, 2010 dhe 2011, të dhënat nga faturimi i KEK-u, të dhënat nga Kosova Thëngjilli dhe analizës së rritjes ekonomike³.

Energjia, e cila konsumohet nga sektori i amvisërisë shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ngrohjen e ujit sanitar, gatim, ndriçim dhe përdorim të pajisjeve elektrike për nevoja familjare dhe individuale.

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2011 ka qenë 490.51 ktoe.

³ Konsumi i energjisë në Kosovë”, realizuar nga Instituti Riinvest ne vitin 2009, Studimi mbi shpërndarjen e konsumit te energjisë ne sektorin e amvisërisë dhe mundësia e përmirësimit te çiençës-realizuar nga Institutu Ìntech” ne vitin 2011, “Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë, realizuar nga CRES-i ne vitin 2011.

Tabela17. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë

Burimi	ktoe
Thëngjill	23.32
Produkte nafte	25.82
Biomasë	222.36
Energji elektrike	216.85
Energji solare	0.19
Ngrohje e përfituar	1.98
Totali	490.51




Figura 15. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (%)

Burimi energjetik më i konsumuar në sektorin e amvisërisë për vitin 2011 është biomasa me një konsum prej 222.36 ktoe ose 45.33% të konsumit total të energjisë së konsumuar në këtë sektor, e pasuar nga energjia elektrike me 216.85 ktoe, me një pjesëmarrje prej 44.21% të konsumit total, produkte nafte me 25.82 ktoe, që është 5.26% e konsumit total, thëngjilli me 23.32 ktoe ose 4.75% e konsumit total të energjisë, ngrohja e përfituar me 1.98 ktoe, ose 0.40% e konsumit total të energjisë. Pjesëmarrja e ulët e ngrohjes së përfituar në konsumin total të energjisë të sektorit të amvisërisë ndërlidhet me:

- Reduktimet kolektive të konsumatorëve të ngrohtoreve të qytetit, sidomos Ngrohtorja Termokos” e Prishtinës, si pasojë e masave ndaj konsumatorëve që nuk kanë paguar energjinë, dhe
- Mungesa e lëndës djegëse për ngrohje (mazutit).

1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë

Në tab.18, shihet se linjiti është thëngjilli më i konsumuar në sektorin e amvisërisë me 23.04 ktoe ose 98.80% të konsumit total të thëngjillit në sektorin e amvisërisë.

Konsumi i secilit lloj të thëngjillit në sektorin e amvisërisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela18. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë

Thëngjill	ktoe
Antracit	0.00
Thëngjill bituminozë dhe tjera	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00
Lignit/thëngjill i murrmë	23.04
Koks dhe gjysmë koks	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.28
Katran	0.00
Torfë	0.00
Totali	23.32




Figura 16. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë (%)

1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë

Në tab.19, shihet se GLN është nënprodukti më i konsumuar i naftës në sektorin e amvisërisë me 10.94 ktoe ose 42.36% të konsumit total, pasuar nga nafta me 8.74 ktoe ose 33.86% dhe benzina me 6.14 ktoe ose 23.78%.

Konsumi i nënprodukteve të naftës në sektorin e amvisërisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela19. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë

Produktet e naftës	ktoe
Benzinë	6.14
Gazoil	0.00
Kerozinë	0.00
Kerozinë (Jet fuel)	0.00
Vajra të rënda /mazut	0.00
Naftë	8.74
GLN	10.94
Koks nafte	0.00
Produkte tjera nafte	0.00
Mbetje nafte	0.00
Bitumen	0.00
Totali	25.82




Figura 17. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë (%)

1.5. Konsumi në sektorin e shërbimeve

1.5.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve

Ashtu si në sektorët e tjerë, të dhënat e konsumit të energjisë për sektorin e shërbimeve në përgjithësi janë bazuar në të dhëna të hulumtimeve për konsumin e vitit 2008, 2009, 2010 dhe 2011, të dhënat nga faturimi i KEK-u, të dhënat nga Kosova Thëngjilli dhe analizës së rritjes ekonomike⁴. Sikurse në sektorin e amvisërisë edhe në sektorin e shërbimeve energjia përdoret për: ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohtë, gatim në restorante, hotele, objekte shëndetësore, kopshte fëmijësh, objekte rehabilitimi, ndriçim publik dhe pajisjet elektrike në objekte të sektorit të shërbimeve.

Gjatë vitit 2011 sektori i shërbimeve ka konsumuar në total 119.57 ktoe. Sektori i shërbimeve kategorizohet në dy nënsektorë kryesorë: publikë dhe privat. Këta përmbajnë një numër të madh të nënsektorëve si p.sh. hotelieri dhe turizëm, shëndetësi, tregti, arsim, zanate (zejtari), konsulencë, kulturë dhe sport, shërbime publike etj.

⁴ Konsumi i energjisë në Kosovë, realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2009, Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë, realizuar nga CRES-i në vitin 2011.

Tabela 20. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve

Burimi	ktoe
Thëngjill	3.92
Produkte nafte	46.06
Biomasë	6.37
Energji elektrike	61.72
Energji solare	0.44
Ngrohje e përfiturar	1.06
Totali	119.57

